



MINISTRY OF HIGHER EDUCATION,
SCIENCE AND TECHNOLOGY



REPUBLIC OF SLOVENIA
MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS



KONFERENCA MINISTRORE

mbi infrastrukturën e informacionit për shkencën, arsimin e kulturën

COBISS 2009

11 dhe 12 nëntor 2009, Kongresi center Habakuk, Maribor, Slloveni

Korniza e përgjithshme

Gjatë kohës së kryesimit të UE-së, Sllovenia ka theksuar veçanërisht rëndësinë e synergjisë (punës së përbashkët) në shkencë, arsim dhe kulturë për zhvillim të përhershëm, dhe këtë e ka sendërtuar edhe në praktikë. Rol qenësor në këtë luajnë bibliotekat, por vetëm me kusht që ato të jenë në kuadër të një sistemi efikas bibliotekar informues që mbështetet nga teknologjia bashkëkohore informuese komunikuese (TIK). Tashmë për një çerek shekulli, IZUM (Instituti i Shkencave të Informacionit) nga Maribori po zhvillon dhe mirëmban një sistem të tillë (COBISS - Sistemi i përbashkët në-linjë i informacionit dhe shërbimeve bibliografike), për veprimtarinë e të cilit ka marrë vlerësime të larta profesionale nga ekspertët ndërkombëtarë. Një karakteristikë e dalluar e sistemit COBISS është përmbushja e nevojave specifike të grupeve të ndryshme të përdoruesve për informacione bibliografike përmes një rrjeti të integruar dhe kësaj është dëshmuar të jetë një sistem universal bibliotekar informues. Përveç operacioneve të zakonshme bibliotekare, ai mbështet transparencën e rezultateve kërkimore, vlerësimin e veprimtarisë kërkimore, procedurat habilituese në arsimin e lartë, paraqitjen e prodhimit artistike, pagimin e kompensimit autorëve të veprave letrare, programet arsimore, etj.

IZUM që nga fillimi i punës, u ofron know-how (njohuritë procedurale) të tij edhe shteteve të tjera në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Sistemet kombëtare bibliotekare që bazohen në platformën COBISS, janë të lidhura në njërin nga rrjetet më të mëdha rajonale evropiane me emërtimin COBISS.Net. Projekti COBISS.Net është njëkohësisht pjesë përbërëse e rëndësishme e bashkëpunimit zhvillimor të Sllovenisë në rajon.

Për dallim nga ata që ofrojnë vetëm pajisjet për automatizimin e bibliotekave, IZUM-i është orientuar në marrëveshje dhe realizimin e përbashkët të sistemeve kombëtare bibliotekare informuese të bazuara në platformën COBISS. Bazuar në këtë është i nevojshëm një bashkëpunim me resorët e autorizuar ministrorë në çdo shtet, si dhe me bibliotekat kombëtare. Konferencat e COBISS-it janë pjesë përbërëse të diskutimeve dhe të një bashkëpunimi të tillë.

Arsyet

Evropa është përcaktuar për një hapësirë të unifikuar kërkimore dhe të shkollimit të lartë dhe në një koncept multikulturor, i cili nënkupton qarkullimin e papenguar të informacionit. Në këtë aspekt, rrjetet bibliotekare kanë rëndësi të jashtëzakonshme, jo vetëm si thesare të krijimtarisë në të kaluarën, por edhe si baza të transparencës të të arriturave aktuale në veprimtarinë kërkimore, arsimore dhe kulturore. Të gjitha pjesët e Evropës duhet të përfshihen në këtë shkëmbim të informacionit dhe vëmendje e posaçme duhet t'u kushtohet rajoneve, të cilat për arsye të ndryshme kanë ngecje në modernizimin e sistemeve të tyre bibliotekare. Sistemi COBISS.Net tashmë lidhë një pjesë të rëndësishme të bibliotekarisë së shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe paraqet një mundësi reale për pjesëmarrjen e tyre në rrjetet globale bibliotekare Evropiane, dhe posaçërisht nëse këto gëzojnë përkrahjen adekuate të qeverive dhe të UE-së. Duhet të jemi të vetëdijshëm për faktin se pa sigurimin e transparencës, praktikisht nuk është e mundur pjesëmarrja në shkëmbimet dhe mobilizimet në fushën e shkencës, arsimit dhe kulturës. Për këtë arsye, Republika e Sllovenisë para disa vjetësh, projektin COBISS.Net e ka parë si një iniciativë shumë të rëndësishme rajonale, prandaj në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar zhvillimor e ka bashkëfinancuar me mjete të konsiderueshme.

Qëllimet

Synimi kryesor i konferencës është thëllimi i njohurive për rëndësinë e gjithanshme të disponueshmërisë së informacionit për potencialet krijuese të shoqërisë së vet – në shkencë, arsim dhe kulturë – si bazë për orientimin real të zhvillimit shoqëror, si dhe shkëmbimit të përvojave për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve bibliotekare informuese dhe sistemeve të informacionit për veprimtarinë kërkimore. COBISS.Net është në fakt një projekt në rrjedhë e sipër, prandaj konferenca është një rast i mirë që ky projekt të vlerësohet. Në këtë aspekt, është veçanërisht e mirëseardhur një nxitje shtesë për zhvillimin e sistemeve informuese kombëtare për përcjelljen në vazhdimësi të rezultateve të veprimtarisë kërkimore, e cila në shumë shtete është në fazën fillestare, prandaj nxitja për zhvillimin e tyre është kusht për kryerjen e vlerësimeve objektive në sektorin e kërkimeve (shkencore) dhe të arsimit të lartë.

Përmbajtja e konferencës

Konferenca COBISS 2009 do të mbahet në Maribor më 11 dhe 12 nëntor 2009 dhe me përmbajtjen e saj do të përfshihet në kontekstin e Vitit Evropian të Krijimtarisë dhe Inovacioneve. Konferenca do të ketë karakter ministror, posaçërisht në trajtimin e disponueshmërisë së informacionit për potencialet dhe rezultatet e veprimtarisë kërkimore për bashkëpunim në rajon. Bëhet fjalë për një temë vitale në kohën e kërkimit të shtegdaljes nga recesioni ekonomik, kur të gjitha shtetet po i drejtohen dijes dhe shkencës, me ç'rast me rëndësi vendimtare është një pasqyrë e përditësuar dhe e plotë e potencialeve të dijes në vend. Paneli në këtë temë do të duhej të tregojë se në kuadër të sistemeve të integruara bibliotekare informuese COBISS dhe sistemeve informuese për veprimtarinë kërkimore SICRIS/E-CRIS mund të sigurojmë mbështetje dhe mjete efikase për këtë qëllim. Në këtë aspekt, është e qartë se kontributi novator i veprimtarisë kërkimore është vetëm pjesë e krijimtarisë më të gjerë kulturore të një mjedisi dhe se zhvillimi dhe përhapja e mendimeve përmes artit është e qenësishme edhe për shkencën dhe për depërtimin e zhvillimit në përgjithësi. Bibliotekat mbledhin dokumentet nga të gjitha sferat e krijimtarisë dhe nëse mbështeten nga TIK, ato mund të ofrojnë edhe pasqyrë të përditësuar të kësaj sfere të jetës në komunitet. Kësaj çështjeje do t'i kushtohet paneli i dytë i konferencës, në të cilin pritet pjesëmarrja e panelistëve shumë kompetentë. Programi i ditës së dytë të konferencës do t'i kushtohet në tërësi temave bibliotekare, me ç'rast do të marrin pjesë ekspertë të njohur nga bota e jashtme dhe nga vendi.

Programi preliminar

E martë, 10 nëntor	
18.00	Regjistrimi Fjala e mirëseardhjes
E mërkurë, 11 nëntor	
9.00	Regjistrimi
10.00	Hapja zyrtare e konferencës <i>Tomaž Seljak</i> (Drejtor i IZUM-it) Fjala e mirëseardhjes në emër të organizatorëve. <i>Vojko Volk</i> (Ministria e Punëve të Jashtme) Sllovenia për afrimin e Ballkanit Perëndimor drejt UE-së <i>Stamenka Uvalič-Trumbić</i> (UNESCO, Paris) Dinamikë e re e shkollimit të lartë dhe kërkimet për ndryshime shoqërore dhe zhvillim
11.00	Paneli: Akresi në informacion për potencialet kërkimore dhe rezultatet e punës kërkimore për bashkëpunimin në rajon Panelin e udhëheq: <i>József Györkös</i> (Sekretar Shtetëror, Ministria e Arsimit të Lartë, Shkencë dhe Teknologji në Qeverinë e Republikës së Sllovenisë). Pjesëmarrës: përfaqësuesit nga ministritë e shkencës, teknologjisë dhe arsimit të lartë nga vendet shtetet që deri tani kanë shfaqur interesim për bashkëpunimin në projektin COBISS.Net
13.00	Dreka
15.00	Paneli: Sistemet e Informacionit Bibliotekar për Paraqitjen e Krijimtarisë Panelin e udhëheq: <i>Majda Širca</i> (Ministre për Kulturë në Qeverinë e Republikës së Sllovenisë) Marrin pjesë përfaqësuesit e ministrive për kulturë të shteteve në rajon Seksioni: NREN <i>Tomaž Kalin</i> (bashkëpunëtor i vjetër) Rrjeti kompjuterik evropian për kërkim dhe arsim. <i>Marko Bonač</i> (Drejtor i ARNES-it) Rrjeti kërkimor dhe akademik i Sllovenisë. Vendndodhja: Dvorana Priol (Salla Priol) Gjuha: Anglisht
16.45	<i>Sir John Daniel</i> (Commonwealth of Learning, Kanada) Përgjigje ndaj nevojave bibliotekare të mësimi në largësi
19.00	Koncerti i grupit Terrafolk në sallën e Union-it dhe pranim në Bodrumin e Verës të Vinagov-it
E enjte, 12 nëntor	
9.00	<i>Karen Calhoun</i> (OCLC, USA) Udhëtim përmes tranzicionit. Nga mbijetesa tek lulëzimi. <i>Marshall Breeding</i> (USA) Gjenerata tjetër e ndërfaqes së përdoruesve Punëtorja: WBC-INCO.NET Integrimi i informacionit për promovimin e potencialeve kërkimore dhe zhvillimore Udhëheqës i punëtorisë: <i>Boris Cizelj</i> (drejtor i SBRA) Vendndodhja: Salla e Kristaltë Pjesëmarrja vetëm me ftesë të posaçme!
10.30	Pushim
11.00	<i>Mirna Willer, Marijana Tomić</i> (Universiteti i Zadarit) Rregullat e katalogimit dhe praktikat në rajon. <i>Primož Južnič</i> (Universiteti i Lubjanës) Prirjet edukative për punë në sektorin informativ. <i>Marta Seljak</i> (IZUM) Si të Racionalizohet Katalogimi dhe të Përmirësohen Funkcionalizimet e Sistemit COBISS? <i>Zoran Krstulović</i> (Biblioteka Kombëtare dhe Universitare në Lubjanë) COBISS.SI dhe DLIB.SI për akses në burimet elektronike.
12.30	Dreka
13.30	<i>Vesna Stevanović</i> (Biblioteka Kombëtare e Serbisë) Organizimi i Qendrës Kombëtare COBISS në Serbi. <i>Nadja D. Karačodžukova</i> (Biblioteka Kombëtare e Bullgarisë), <i>Simona Tušek</i> (IZUM) Konvertimi i Katalogut të Bibliotekës Kombëtare të Bullgarisë në formatin COMARC <i>Miro Kolarič</i> (IZUM) Migrimi tek aplikimet COBISS3 <i>Përfaqësuesi i sponsorit (ADD)</i> Infrastruktura moderne e IT-së në biblioteka
15.15	Mbyllja e konferencës
20.00	Darkë lamtumire

Përkthimi do të ofrohet në gjuhën sllovene, angleze, boshnjake/kroate/serbe/malaziase, bullgare, maqedonase dhe shqipe.